


korrik 2017

gap | analizë

Sa kanë kompetenca vetanake komunat?





Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e **Institutit GAP** dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

Hyrje

Kompetencat e pushtetit lokal rregullohen me Kushtetutën e Kosovës dhe me Ligjin për vetëqeverisje lokale. Sipas Kushtetutës, komunat janë njësi themelore të vetëqeverisjes lokale dhe organizimi dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes lokale rregullohen me ligj.¹ Ligji për vetëqeverisje lokale² është ligji bazik i cili përcakton kompetencat dhe organizimin e komunave. Ky ligj ka hyrë në fuqi në qershor 2008 dhe bën pjesë në pakon e ligjeve bazike të shtetësisë, apo siç njihen “ligjet e Pakos së Ahtisaarit”. Këto ligje janë aprovuar në mënyrë të përshpejtuar gjatë periudhës 120 ditore të tranzicionit nga shpallja e pavarësisë (17 shkurt 2008) e deri në hyrjen e tyre në fuqi më 15 qershor 2008.

Ligji për vetëqeverisjen lokale bën pjesë në ligjet me interes vital. Miratimi, ndryshimi dhe shfuqizimi i ligjeve me interes vital kërkon votat e shumicës së dyfishtë në kuvend, pra shumicën e votave të të gjithë deputetëve, si dhe shumicën e votave të deputetëve që përfaqësojnë komunitetet pakicë.³ Ky rregull, ka bërë që Ligji për vetëqeverisje lokale mos të ndryshohet që nga aprovimi i tij nëntë vite më parë, përkundër asaj se janë shfaqur mangësi të mëdha në këtë ligj. Dy vite pas aprovimit të Ligjit për vetëqeverisje lokale, qeveria kishte filluar procedurat për ndryshimin dhe plotësimin e tij, sidomos në pikat që kanë të bëjnë me menaxhimin e pronës komunale, bashkëpunimin ndërkuftar, procedurat për shkarkimin e kryesues-it/es të kuvendit, emërimin e drejtor-it/eshës të administratës dhe personelit, etj.⁴

Në pamundësi për të ndryshuar Ligjin për vetëqeverisje lokale, qoftë për shkak të mos konsensusit politik në mes të partive të shumicës, apo për shkak të frikës së mos votimit të ndryshimeve nga partitë që përfaqësojnë komunitetet pakicë, është munduar që të plotësohet legjislacioni i vetëqeverisjes lokale duke adaptuar ligje ose ndryshuar ligjet të tjera sektoriale.

Në këtë raport, Instituti GAP ka analizuar kompetencat e komunave të definuara me Ligjin për vetëqeverisje lokale, duke krahasuar atë me

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 12.

² Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, I aprovuar më 20 shkurt 2008. Burimi: <http://bit.ly/1CulaKA> (hapur së fundmi më 18 prill 2017).

³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 81.

⁴ Për më shumë, shih analizën e Institutit GAP “Rregulli 61 – Ligjet e Ahtisaarit, pasojat dhe mësimet e nxjerra nga miratimi i ligjeve në procedurë të përshpejtuar. Dhjetor 2010. Burimi: <http://bit.ly/1YvYncl> (hapur së fundmi më 18 prill 2017).

ligjet tjera sektoriale. Në veçanti, raporti analizon se sa kanë kompetenca komunat në zhvillimin ekonomik lokal, menaxhimin e pronës komunale, menaxhimin me mbeturina, furnizimin me ujë, mbrojtjen e mjedisit lokal, përgjigjet ndaj rasteve emergjente lokale, etj.

Metodologjia

Instituti GAP i ka rekomanduar Komisionit Parlamentar për Administratë Publike, Qeverise Lokale dhe Media që në planin e punës për vitin 2017 të përfshihet edhe monitorimi i zbatueshmërisë së Ligjit për vetëqeverisje lokale, me theks të veçantë në konfliktin e kompetencave në mes të nenit 17 të ligjit dhe ligjeve tjera në fuqi. Komisioni parlamentar ka aprovuar rekomandimin tonë, dhe me planin e punës së komisionit parashihet monitorimi i Ligjit për vetëqeverisje lokale.⁵ Në funksion të kësaj, GAP ka marrë përsipër që të asistojë komisionin duke analizuar ligjet të cilat bien ndesh me Ligjin për vetëqeverisje lokale. Kjo analizë, e cila ka për qëllim që të shërbejë si bazë për punën e komisionit në monitorimin e ligjit, ka marrë parasysh edhe mendimet e pesë kryetarëve të komunave, atij të Drenasit, Hanit të Elezit, Kaçanikut, Vitisë dhe Obiliqit.

Kompetencat vetanake të komunave

Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, komunat kanë kompetenca vetanake, kompetenca të deleguara dhe kompetenca të zgjeruara. Kompetencat vetanake nënkuptojnë se komunat kanë pushtet të mjaftueshëm që të menaxhojnë me disa fusha për të cilat ligji u jep pushtet të plotë. Kompetencat e deleguara janë kryesisht shërbime të cilat komunat i kryejnë për nivelin qendror, si për shembull shpërndarja e asistencës sociale, kurse kompetenca të zgjeruara janë ato kompetenca të cilat i gëzojnë disa komuna me shumicë serbe, si për shembull menaxhimi me shëndetësinë sekondare.

Neni 17 i Ligjit për vetëqeverisje lokale liston të gjitha kompetencat vetanake të komunave. Sipas këtij neni, komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive në këto fusha:

- Zhvillimin ekonomik lokal;
- Planifikimin urban dhe rural;
- Shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;

⁵ Lajmi zyrtar i Kuvendit të Kosovës, pas takimit të Komisionit parlamentar për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media më 1 shkurt 2017. Burimi: <http://bit.ly/2oSSCHO> (hapur së fundmi më 12 maj 2017).

- Zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
- Mbrojtjen e mjedisit lokal;
- Ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehtësie lokale;
- Përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale;
- Ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;
- Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- Ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor;
- Ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cënueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijëror, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;
- Banimin publik;
- Shëndetësinë publike;
- Licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë;
- Emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- Ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike;
- Turizmit.

Për qëllimet e kësaj analize të shkurtër, jemi fokusuar në disa nga fushat kryesore nga neni 17 për kompetencat vetanake dhe i kemi krahasuar ato me kompetencat reale të komunave, si: zhvillimi ekonomik lokal, furnizimi me ujë, menaxhimi i mbeturinave, emergjencat lokale, mbrojtja e mjedisit dhe shëndetësia primare.

Zhvillimi ekonomik lokal

Një nga fushat në të cilat komunat nuk pajtohen se kanë kompetenca të plota është ajo e zhvillimit ekonomik lokal. Pesë kryetarët e komunave të cilët i kemi intervistuar, si dhe të tjerë⁶ të cilët kanë shprehur

⁶ Një pakënaqësi të tillë e kanë shprehur disa here publikisht edhe kryetarja e Komunës së Gjakovës znj. Mimoza Kusari-Lila, dhe kryetari i Mitrovicës z. Agim Bahtiri. Në një intervistë për "Zëri", Bahtiri kishte folur për problemet e

pakënaqësitë e tyre përgjatë këtyre viteve, ankohen se niveli qendror dhe ligjet në fuqi ua pamundësojnë komunave që të ndërmarrin veprime për zhvillim ekonomik lokal.

Komunat më së shumti hasin në vështirësi sa i përket menaxhimit me pronën komunale, apo më saktë mungesa e pronës e cila mund t'i ofrohet investitorëve. Shumë komuna nuk kanë fare pronë komunale, kurse prona shoqërore menaxhohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP). Ligji për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës parasheh edhe procedurat për bartjen e pronësisë nga AKP tek komunat.⁷ Por, komunat ankohen se ky proces merr kohë të gjatë dhe nuk mund t'i përgjigjen me kohë kërkesave të investitorëve potencial.

Në anën tjetër, edhe në rastet kur komunat kanë të drejta të plota për të dhënë në shfrytëzim tokën komunale, zakonisht kjo është dhënë si pronë për ndërtim të objekteve kolektive të banimit, por jo si mundësi për zhvillim të qëndrueshëm lokal.⁸

Problem tjetër sa i përket zhvillimit ekonomik lokal është edhe krijimi i ndërmarrjeve publike (NP) lokale. Disa komuna në Kosovë, shërbimet e caktuara që lidhen me çështjet e zhvillimit ekonomik sikurse menaxhimi i tregjeve apo menaxhimi i hapësirave publike banesore, i ushtrojnë përmes NP-ve. Sipas nenit 11.3 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për NP, komunat kanë të drejtë për krijimin e NP-ve lokale në pajtim me kriteret e përcaktuara me aktet nën-ligjore të qeverisë. Mirëpo, Neni 11.1 i këtij ligji specifikon se një ndërmarrje publike mund të krijohet vetëm nëse autorizohet me një vendim nga qeveria.⁹

Varësia e komunave për krijimin e NP-ve lokale nga qeveria ka krijuar probleme në të kaluarën qoftë për shkak të vonësive në përgjigje nga

shumta në fushën e zhvillimit ekonomik lokal. Burimi: <http://bit.ly/2swv5kU> (hapur së fundmi më 15 maj 2017).

⁷ Neni 9 i Ligjit nr.03/L-226 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës. Burimi: <http://bit.ly/2sejxO4> (hapur së fundmi më 30 maj 2017).

⁸ Disa komuna, si për shembull Komuna e Gjilanit, Komuna e Klinës, e komuna tjera, përmes Ligjit për partneritet publiko-privat, kanë ndarë pronën komunale për ndërtim të objekteve kolektive të banimit, në kompensim të shfrytëzimit të një pjese të ndërtimit nga komuna, ose edhe më keq, si pronë e bartur tek liderët politik komunal. Për më shumë informata lidhur me keqpërdorimet e komunave të projekteve të partneriteti publiko-privat, lexo raportin e GAP "Letërnjoftimi i Komunës së Gjilanit 2013 (Burimi: <http://bit.ly/2sGczXG>) dhe "Letërnjoftimi i Komunës së Klinës 2012" (Burimi: <http://bit.ly/2sGib40>).

⁹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Burimi: <http://bit.ly/1vs647w>

niveli qendror apo për shkak të refuzimeve ndaj kërkesave të komunave për themelimin e NP-ve. Në rastin e themelimit të NP-së lokale “Prishtina Parking”, Komuna e Prishtinës është dashur të pres më shumë se një vit për aprovim nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik.¹⁰ Me Projektligjin për kryeqytetin e Republikës së Kosovës - Prishtinën, Komuna e Prishtinës do të mund të krijojë ndërmarrje publike lokale vetëm me miratimin e Kuvendit Komunal, pa pasur nevojë të miratimit nga Qeveria e Kosovës. Kjo e drejtë do të duhej t’i jepej edhe komunave tjera të mëdha në Kosovë në mënyrë që këto komuna të kenë pavarësinë e nevojshme për përdorimin e NP-ve në funksion të zhvillimit ekonomik.

Furnizimi me ujë

Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, furnizimi me ujë është kompetencë e komunave. Por, në praktikë, furnizimi me ujë bëhet nga kompanitë rajonale të ujësjellësve, aksionar i së cilave është Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Në Kosovë funksionojnë shtatë kompani rajonale të ujësjellësit (KRU) të cilat ofrojnë shërbime për komuna apo rajone të ndryshme të Kosovës. Në bazë të pronësisë, gjashtë nga shtatë KRU-të janë në pronësi të Qeverisë së Kosovës, ndërsa vetëm KRU Bifurkacioni është në pronësi lokale (Komuna e Ferizajt dhe Komuna e Kaçanikut).

Nga viti 2012, sipas Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, komunat kanë të drejtë të propozojnë kandidatë për anëtarë të bordeve të KRU-ve. Procedura e nominimit dhe zgjedhjes së kandidatëve për drejtorë të bordeve të KRU-ve nga komunat përcaktohet me akt nënligjor. Në bazë të udhëzimit administrativ për pjesëmarrjen e komunave në borde të ndërmarrjeve rajonale të ujit, bordi i KRU-ve përbëhet nga gjashtë anëtarë dhe kryeshefi ekzekutiv. Fillimisht, komunat nominojnë të paktën tre kandidatë më tepër se pozitat e rezervuara për drejtorë të komunave. Më pas, komisioni rekomandues (niveli qendror) bën një vlerësim nëse kandidatët i plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuar në Ligjin për NP. Në fund, komunat bëjnë nominimin e tre kandidatëve kryesor (përfshirë kandidatin/en për komunitete pakicë) dhe tre kandidatëve rezerve për anëtarë të bordeve përmes Asociacionit të Komunave. Renditja e të nominuarve nga komunat me prioritet bëhet varësisht nga numri i konsumatorëve. Në anën tjetër, megjithëse komunat kanë të drejtë nominimi për drejtorë të bordeve, të drejtën për mbikëqyrjen dhe shkarkimin e anëtareve të bordeve (përfshirë atyre të

¹⁰ Instituti GAP, Shërbimet Publike Komunale dhe Ndërmarrjet Publike, Burimi: <http://bit.ly/22PG54x>

kandiduar nga komunat) të KRU-ve ka vetëm qeveria pas rekomandimit të Njesisë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike (NjMNP).¹¹

Sipas Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit, sa i përket furnizimit dhe menaxhimit me ujë, komuna është vetëm vëzhguese dhe raportuese e gjendjes, por pa kompetenca për të ndikuar në menaxhim. Sipas tij, në vitin 2010, Komuna e Hanit të Elezit me ndihmën e donatorëve ka ndërtuar fabrikën për trajtimin e ujit të pijes, por në mungesë të menaxhimit të saj nga KRU “Bifurkacioni”, kjo fabrikë ka mbetur jashtë funksionit. Kuvendi Komunal i Hanit të Elezit kishte marrë vendim për themelimin e një ndërmarrjeje lokale për menaxhimin me ujëra, por ky vendim ishte hedhur poshtë nga Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal.

Edhe kryetari i komunës së Vitisë, ai i Obiliqit dhe ai i Drenasit kanë thënë se nuk janë ndarë të kënaqur me bashkëpunimin në mes të komunës dhe kompanisë rajonale të ujësjellësit.

Menaxhimi i mbeturinave

Edhe menaxhimi i mbeturinave është kompetencë vetanake e komunave sipas nenit 17 të Ligjit për vetëqeverisje lokale. Por në praktikë, më shumë se kompetencë vetanake, menaxhimi i mbeturinave bie në kompetencë të kompanive rajonale të cilat funksionojnë si shoqëri aksionare. Sipas Ligjit për ndërmarrjet publike, ekzistojnë 11 kompani të mbeturinave, në pesë prej të cilave komunat kanë pronësi 100% (Gjakova, Mitrovica Veriore, Zveçani, Leposaviçi dhe Zhubin Potoku), kurse kompanitë tjera janë kompani rajonale, bordi i të cilave përbëhet nga dy e më shumë komuna.¹² Për shembull, Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” ofron shërbime në tetë komuna. Obiliqi merr pjesë me 3% të aksioneve dhe së bashku me Fushë Kosovën kanë një përfaqësues në bord.¹³ Komunat e vogla si Obiliqi me aksione të ulëta dhe me pjesëmarrje të kufizuar në borde të kompanive rajonale ankohen se komunat e mëdha i mbivotojnë dhe grumbullimi i mbeturinave është më efikas në qytetet e mëdha se sa në qytetet e vogla.

¹¹ Për informata shtesë, lexo analizën e GAP “Shërbimet publike komunale dhe ndërmarrjet publike”, publikuar në qershor 2015. Burimi:

<http://bit.ly/22PG54x> (hapur së fundmi më 8 qershor 2017).

¹² Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike. I plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.05/L-009 dhe Ligjin nr.04/L-111. Burimi: <http://bit.ly/1vs647ë>

¹³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Udhëzimi administrative nr.03/2009 për mënyrën e përfaqësimit të komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve publike lokale. Burimi: <http://bit.ly/2o03AKT>

Për këtë arsye, Komuna e Kamenicës në gusht të vitit 2011 ka themeluar ndërmarrje lokale për grumbullimin e mbeturinave, me arsyetimin se Kompania Rajonale e Mbeturinave “Eco-Higjiena” po e diskriminonte Komunën e Kamenicës.¹⁴ Komuna e Hanit të Elezit dhe ajo e Graçanicës kanë aplikuar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik për themelimin e një ndërmarrjeje lokale për menaxhim të mbeturinave.¹⁵

Komunës së Hanit të Elezit i është dashur të pres gati dhjetë vite që kërkesa e tyre për krijimin e një kompanie për menaxhimin e mbeturinave të aprovohej nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Kjo kompani ka filluar punën nga janari i vitit 2017.

Në anën tjetër, Komuna e Obiliqit edhe pse është e kënaqur me menaxhimin e mbeturinave nga ana e kompanisë rajonale, një problem të cilin ata nuk kanë kompetencë që të intervenojnë e që ndodhet në komunën e tyre, është deponia për grumbullimin e mbeturinave e cila ndodhet në fshatin Mirash. Kjo deponi paraqet rrezik të madh shëndetësor për banorët, por ajo menaxhohet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Menaxhimi i rasteve emergjente lokale

Ligji për vetëqeverisje lokale konsideron se komunat kanë përgjegjësi dhe kompetenca për të reaguar në rast të emergjencave lokale. Ligji për zjarrfikje dhe shpëtim obligon Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave për themelimin e qendrave të zjarrfikësve, kurse komunat obligohen që të themelojnë vetëm njësitë e vullnetarëve.¹⁶

Sipas një raporti të publikuar nga Instituti GAP më 2016, del se komunat kanë paqartësi se kush i menaxhon njësitë e zjarrfikëseve.¹⁷ Komunat vazhdojnë të paguajnë për mirëmbajtjen e automjeteve, për furnizim

¹⁴ Në qershor të vitit 2014, kompania e themeluar nga Komuna e Kamenicës l kaloi komplet në menaxhim “Kompanisë Rajonale të Mbeturinave “Eco-Higjiena”. Më shumë informata mund të gjenden në analizën e GAP “Shërbimet publike komunale dhe ndërmarrjet publike”, publikuar në qershor 2015. Burimi: <http://bit.ly/22PG54x>

¹⁵ Procedurat për krijimin e ndërmarrjeve të reja lokale parashihen me Rregulloren nr.02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale. Burimi: <http://bit.ly/2nGfIVo>

¹⁶ Neni 4 i Ligjit NR. 04/-L-049 për zjarrfikje dhe shpëtim. Burimi: <http://bit.ly/1W0cQjY> (hapur së fundmi më 5 qershor 2017).

¹⁷ Instituti GAP. Sfidat e komunave në zbatimin e ligjeve. Maj 2016. Burimi: <http://bit.ly/2nZF4hp> (hapur së fundmi më 30 maj 2017).

me derivate, për blerjen e pajisjeve dhe për rregullimin e objekteve. Kjo vjen edhe përkundër që kompetenca e menaxhimit të njësive të zjarrfikëseve i është bartur Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Në disa komuna, si në Han të Elezit dhe në Mitrovicë, zjarrfikësit paguhen nga komunat, kurse në disa komuna të tjera janë larguar nga lista e pagave të nivelit lokal dhe janë bartur në listën e të punësuarve të AME-së.

Komunat e intervistuar për këtë raport janë shprehur në favor të bartjes së kompetencave për menaxhimin e shërbimeve të zjarrfikësve tek niveli qendror, me arsyetimin e krijimit të një sistemi unik, vendosjen e standardeve, gradimin, etj.

Mbrojtja e mjedisit

Edhe mbrojtja e mjedisit është fushë e cila i lihet në kompetencë komunave. Por, në praktikë, kompetencat më të mëdha në këtë fushë i takojnë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe Ligji për mbrojtjen e mjedisit i japin kompetenca nivelit qendror për të intervenuar në mbrojtjen e mjedisit, kurse komunat obligohen që të aprovojnë plane për mbrojtjen e ujërave, mbrojtjen nga zhurma, mbrojtjen e bimëve, etj.

Sipas një hulumtimi të mëhershëm të Institutit GAP, del se përkundër asaj se komunat nuk kanë kompetenca të mjaftueshme në mbrojtjen e mjedisit, shumica nga komunat nuk i kanë përmbushur obligimet që dalin nga ligjet në këtë fushë.¹⁸ Sipas raportit në fjalë, mbi 60% e komunave nuk kanë inspektorë të mjedisit, mbi 70% e komunave nuk kanë plane për mbrojtjen e ujërave, mbi 70% e komunave nuk kanë plane për mbrojtjen e ajrit, etj.

Por, në anën tjetër, disa komuna, sidomos ato komuna të cilat ndodhen në zonat e mbrojtjes së veçantë apo zonat ku ndotësit e ajrit janë në nivele më të larta, nuk kanë kompetenca për të zgjidhur problemet me mjedisin në territorin e komunës së tyre. Në këto zona bëjnë pjesë Komuna e Hanit të Elezit, Komuna e Obiliqit dhe Komuna e Drenasit. Të tri këto komuna janë shprehur të pakënaqura me kompetencat e tyre sa i përket mbrojtjes së mjedisit, si dhe me gatishmërinë e MMPH për të asistuar komunat në tejkalimin e problemeve në këtë fushë.

Edhe Komuna e Prishtinës, si një ndër komunat më të mëdha të Kosovës, deklarohet se nuk ka kompetenca për të intervenuar në zgjidhjen e problemeve me ndotjen e ajrit, ndotje e cila gjatë dimrit

¹⁸ Institutit GAP. Sfidat e komunave në zbatimin e ligjeve. Maj 2016. Burimi: <http://bit.ly/2nZF4hp> (hapur së fundmi më 30 maj 2017).

është shumë e lartë në Prishtinë për shkak të afërsisë së termocentraleve, veturave të vjetra dhe djegies së qymyrit për ngrohje nga ekonomitë familjare.

Shëndetësia primare

Shëndetësia primare menaxhohet nga komunat përmes qendrave të mjekësisë familjare. Punësimi i stafit dhe ndarja e detyrave menaxheriale janë kompetencë e komunave, kurse përcaktimi i nivelit të pagave është kompetencë e nivelit qendror. Menaxhimi i suksesshëm i shëndetësisë primare varet edhe nga furnizimi i suksesshëm me barna. Por, furnizimi me barna të cilat janë pjesë e listës esenciale të barnave është kompetencë e Ministrisë së Shëndetësisë.

Të gjitha komunat e intervistuar gjatë këtij hulumtimi janë shprehur të pakënaqura me furnizimin me barna nga lista esenciale. Mos furnizimi me barna, sipas kryetarëve të komunave, i ndikon për keq të gjitha shërbimet në shëndetësinë primare.

Përfundime dhe rekomandime

Nga të dhënat e paraqitura në këtë analizë del se komunat në Kosovë nuk ushtrojnë kompetenca të pavarura, por ato vazhdojnë të jenë të varura nga institucionet e nivelit qendror. Kjo ndërvarësi i bën në shumicën e rasteve komunat të duken si mekanizma në shërbim të nivelit qendror.

Nga 19 kompetencat vetanake që i parasheh Ligji për vetëqeverisje lokale, asnjëra nuk ushtrohet ekskluzivisht vetëm nga komuna. Pjesa më e madhe e këtyre kompetencave mund të ushtrohen pas procedurave ose pajtimeve që duhet të marrin komunat nga niveli qendror. Madje një pjesë tjetër e këtyre kompetencave mund të ushtrohen direkt nga niveli qendror.

Duke u bazuar në këtë, Instituti GAP rekomandon:

- Ndryshimin e Ligjit për vetëqeverisje lokale, i cili do u jepte kompetenca më të mëdha komunave, duke forcuar edhe më tej kompetencat vetanake të listuara në nenin 17 të ligjit në fuqi. Përveç kësaj, duhet ndryshuar një mori ligjesh sektoriale¹⁹ me qëllim të evitimit të konfliktit mes ligjeve.


¹⁹ Siç mund të jenë Ligji për ndërmarrjet publike, Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme, Ligji për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut, Ligji për zjarrfikje dhe shpëtim, etj.

- Ndryshimet në Ligjin për vetëqeverisje lokale duhet që krahas kompetencave vetanake, atyre të deleguara dhe kompetencave të zgjeruara, të parashihen edhe kompetencat asimetrike në mes të komunave, me qëllim të mos trajtimit të barabartë të komunave të mëdha, si për shembull Prishtinë, me komunat më të vogla, si Mamusha. Po ashtu, ndarja e kompetencave asimetrike mes komunave do të duhej të bëhej konform performancës së komunave dhe të jetë proces i vazhdueshëm i dhënies dhe kufizimit të kompetencave varësisht nga performanca e administratës lokale.
- Komunat do të duhej të kishin më shumë kompetenca në menaxhimin e ndërmarrjeve publike, sidomos ato të shërbimeve publike, siç janë kompanitë e ujësjellësit dhe kompanitë e mbeturinave, si dy shërbime bazike komunale. Kjo duhet të bëhet përmes aprovimit të një ligji të ri për ndërmarrjet publike, i cili ndër të tjera do të parashihte procedura më të shpejta për trajtimin dhe aprovimin e kërkesave të komunave për themelimin e ndërmarrjeve publike lokale.
- Qeveria e Kosovës, Agjencia Kosovare e Pronës, Agjencia e Pyjeve, Agjencia Kosovare e Privatizimit si dhe komunat duhet të formojnë një komision për t'i parë modalitetet e bartjes së disa pronave nga të tanishme shoqërore në prona komunale me qëllim të ushtrimit më të lehtë nga komunat në zbatimin e kompetencave sa i përket zhvillimit ekonomik lokal dhe menaxhimit të pronave.

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE



Instituti GAP është Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.



Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e **Institutit GAP** dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

Instituti GAP mbështetet nga:

